

# UNIONBANK

VENDIM NR. 7 DATË 10 TETOR 2023  
I AKSIONARIT TË VETËM

Sot, në datën 10 tetor 2023 (*dymijë e njëzetë e tre*), UNION BANK Sh.A. shoqëri tregtare e themeluar në formën juridike të shoqërisë aksionare, e identifikuar në Regjistrin Tregtar me numër unik të identifikimit të subjektit K51807801R, me seli në Njësinë Bashkiake Nr.9, Sheshi "Ferenc Nopçka", Ndërtesa Nr.5, Kodi Postar 1016, Tiranë, Shqipëri, në cilësinë e aksionarit të vetëm të Shoqërisë "LANDESLEASE" Sh.A. (në vijim "Landeslease") një shoqëri tregtare e regjistruar në formën juridike të shoqërisë aksionare, e identifikuar nga numri unik i identifikimit të subjektit K51629002M, me adresë të selisë në Njësinë Administrative Nr. 9, Rruga "Mine Peza", Ndërtesa nr. 8, Tiranë, Shqipëri, në zbatim të Nenit 9.6.8 të Statutit të Landeslease dhe të Nenit 135 të Ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të ndryshuar vendosi:

- a) Të miratojë emetimin nga Landeslease të 223.234 aksione të reja (dyqind e njëzetë e tre mijë e dyqind e tridhjetë e katër).
- b) Aksionet e reja të emetuara do të marrin numrin sekuencial nga 296.767 deri në numrin 520.000.
- c) Çmimi i aksioneve të Landeslease edhe pas emetimit të aksioneve të reja do të vijojë të jetë 1.000 Lekë/aksiون (vetëm një mijë Lek).
- d) Të miratojë rritjen e numrit të aksioneve të Union Bank Sh.A. nga 296.766 në 421.200 aksione (katërqind e njëzetë e një mijë e dyqind), sipas numrave sekuenciale që i korrespondojnë, pas pagesës nga kjo e fundit të çmimit të aksioneve të emetuara në vlerën 124.434.000 Lekë (njëqind e njëzetë e katër milion e katërqind e tridhjetë e katër mijë) në llogarinë e Landeslease.
- e) Të miratojë nënshkrimin e 98.800 aksioneve (nëntëdhjetë e tetë mijë e tetëqind) nga ana e shoqërisë Unioni Financiar Tiranë Sh. A. një shoqëri tregtare e regjistruar në formën juridike të shoqërisë aksionare, e identifikuar nga numri unik i identifikimit të subjektit J62424002G, me adresë të selisë në Rruga "Ismail Qemali", Nr.32, Kati 3, Kodi Postar 1019, Njësia Bashkiake Nr.5, Tiranë, Shqipëri, me vlerën e tyre të treguar në pikën c).
- f) Të miratojë nënshkrimin e aksioneve të sipërpërmendura, për vlerën totale prej 98.800.000 Lekë (nëntëdhjetë e tetë milion e tetëqind mijë), pronësi e cila do të kalojë në favor të Unionit Financiar Tiranë përkundrejt pagimit të vlerës të sipërpërmendur nga ky i fundit, pagesë e cila do të shkojë për rritjen e vlerës së kapitalit të Landeslease. Union Financiar Tiranë Sh.A. do të mbajë aksionet me numër sekuencial nga 421.201 deri në numrin 520.000.
- g) Të miratojë nënshkrimin e aksioneve sipas marrëveshjes për nënshkrimin e aksioneve me Unioni Financiar Tiranë dhe Union Bank sh..a (duke hequr dorë nga e drejta e parablerjes për aksionet e emetuara).
- h) Të miratojë rritjen e kapitalit të Landeslase pas pagesës së çmimit të Kontratës së Shitjes nga Unioni Financiar Tiranë dhe pagesës nga Union Bank Sh.A. të shumës për çmimin e aksioneve të emetuara. Vlera e re e kapitalit të Landeslease do të jetë 520.000.000 Lekë (pesëqind e njëzetë milion Lekë), ku Union Bank Sh.A. do të zotërojë 81 % të kapitalit (tetëdhjetë e një përqind) dhe UFT do të zotërojë 19 % te Kapitalit.
- i) Të autorizojë Administratorin e shoqërisë të ndjekë procedurat për të aplikuar, depozituar dhe regjistruar këtë vendim në Qendrën Kombëtare të Biznesit/ e-albania, si dhe të njoftojë Bankën e Shqipërisë ose në çdo organ tjeter që mund të kërkohet, si dhe të depozitojë çdo dokument tjeter të nevojshëm për zbatimin e këtij vendimi.

**AKSIONARI I VETËM I LANDESLEASE SH.A.**

**UNION BANK Sh.A.**

**Përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv**

**Znj. Flutura Veipi**

